

GJUHA SHQIPE - DËSHMI E SË VËRTETËS HISTORIKE

Atje lart në ato male , një ditë udhë prej këtu (Shkodrës), njerëzit jetojnë siç kanë jetuar para njëzet shekujsh, para se të dinte kush për grekët, romakët apo sllavët. Atje lart ka qytete parahistorike, gjallërojnë legjenda, këngë e zakone që kurrë s' i ka dëgjuar kush.

Francesa Hardi

Ky frymëzim historik i albanologes Francesa Hardi dhe amerikanes Rose W.Lane u bë shkas i një «kuvëndi » të pazakontë deri më sot në shkencën e Lashtësisë, ku u përballën legjendat popullore të malësorëve shqiptarë të Thethit, me botimet e studiuesve botërorë, mbi popujt e parë të Gadishullit dhe origjinën arbërore apo greke të Aleksandrit të Madh (356 – 323 p.e.r.).

Miket dëgjuan të habitura emrat e 21 mbretëve paraardhës të Lekës së Madh, siç e thërrisnin ata, si dhe Emadhinë e Mat-it (Shqipëri) ku ai kishte lindur. Rreth zjarrit të vatrës, plaku i shtëpisë së Sadri Llukës, u tregoi se ky bir i dy prindërve shqiptarë, u pais me shumë dituri nga bashkombasi i besuar i Filipit II-të të Maqedonisë, Aristoteli (384–322 p.e.r.) i fisit të Ajeropit, i vendosur në Maqedoni.

Në qëndër të këtij « kuvëndi » shtrohej problemi i origjinës etnike të figurave historike dhe mitike të popujve në Gadishullin pellazgjik (ballkanik), që vijon t' i përball studiuesit edhe në ditët e sotme. Duke qënë një problem që lidhet me të VËRTETËN dhe METODËN në shkencën historike, do të nisim me gjurmimin historik dhe gjuhësor mbi fiset që emërtohen «greke » dhe « shqiptare ».

Grekët si fise Indoeuropiane

Historia e Lashtësisë fillon me ardhjen e fiseve Indoeuropiane, midis të cilëve edhe fiset « greke ». Gjuhëtari Francesco Villar (*Gli indoeuropei e le origini dell'Europa. Lingua e storia.*) pohon se: « Fiset indoeuropiane të etnis greke, janë çfaqur në Greqi në periudhën e Bronzit (...) Këto fise vinin, ka shumë mundësi, nga Epiri dhe Thesalia qëndrore, duke zhvilluar në Greqi atë që ne e përcaktojmë Qytetrim mikenian, qytetrim që rënohet rreth shk.XII p.e.r , kur , ka shumë mundësi, janë çfaqur në gadishull fiset, gjithëmonë indoeuropiane, të Dorëve ». (1)

Nga 14 teza të shtruara në shk. 19-të e deri në ditët e sotme dhe e para historikisht, origjina e fiseve Indoeuropiane shikohet në Indi, bazuar tek gjuha sanskrite e pranuar si më e lashta. Kjo ide u mbështet nga [Gordon Childe](#) (*The Aryans*,1926) me teorinë e tij, mbi pushtimet e fiseve të ashtuquajtura « arjane » të stepave aziatike, që u përhapën drejt Perëndimit. (2)

Giuseppe Ciardi-Dupre në Enciklopedinë Italiane (1933) sqaron se shprehja « indoeuropian » duhet kuptuar si « popuj që flasin gjuhët indoeuropiane » (...) **Me një fjalë, ka një lloj gjuhësie indoeuropiane, por nuk ka asnjë fis apo racë indoeuropiane.** (3) Metoda e ndjekur për tezën « indoeuropiane » ka qënë krahasimi i fjalëve të përbashkëta apo të ngjashme në gjuhët e popujve të ndryshëm, me synimin e zbulimit të historisë së gjuhëve në Euro-Azi dhe të gjuhës « mëmë »- rrënjë e përmes gjuhësore.

Kjo metode ka pesë mangësi kryesore :

1. Janë krahasuar gjuhët e vjetra me të reja , si dhe dukuritë gramatikore, si mbaresat, parashtesat, nyjet, kohët e foljeve, etj. që janë dukuri të periudhave më të vona historike të gjuhëve në studim.

2. Nuk është marrë parasysh historia e popujve, mbi gjuhët e të cilëve bëhet studimi, levizjet dhe përzjerjet (sidomos me ato mongole) që kanë pësuar ndër shekuj apo çfaqja e vonshme si popull dhe gjuhë, siç janë fiset sllave të Gadishullit ballkanik.

3. Nuk është marrë parasysh dallimi midis gjuhëve « naturale » (i popujve parahistorik) dhe atyre të ndërtuara artificialisht (gjuhët kishtarë apo të shekullit 18-19).

4. Mos përqëndrimi tek fiset Atlantido-Pellazge, fiset e para që njih historia europiane. Emigrimet dhe pushtimet e tyre, për një periudhë shumë të gjatë kohore, kanë lënë gjurmë në popullsinë e Euro-Afro-Azisë. Gjuha e tyre gjallon akoma, e folur dhe e shkruar, dhe me një fond të pasur dialektor dhe folklorik tek pasardhësit e tyre historik.

5. Përjashtimi në studim, i shkencave të tjera ndihmëse si Besimi (emrat në teologji dhe mite, emërtimet e riteve, objekteve fetare, etj.), Historia, Arkeologjia (epigrafet), Gjeografia (emërvendet), dhe sidomos Dialektologjia e gjuhës shqipe, të cilat kanë lidhje me lashtësinë e gjuhëve dhe të popujve. etj.

Mangësinë më të rëndësishme në metodën e Gjuhësisë krahasuese dhe historike e zbulon Petro Zheji « *Shqipja dhe Sanskritishtja* » duke theksuar se : **gjuha e cila e shpjegon kuptimin gjuhësor të fjalëve në gjuhët e tjera** (që përputhet tek emrat edhe me mitin - shën im), **që ato vetë nuk e arrijnë ta bëjnë, është më e lashta.** (4)

Poshtë kemi tre shëmbujt, një i mitit pellazg (grek, sipas Historisë botërore) dhe dy fjalë nga mitet budiste në gjuhën sanskrite.

- a- Emri më i rëndësishëm i mitologjisë Dodonase –Zeusi, sipas Pitagorës shqiptohet « Zan ». Mbas shumë kërkimesh, pohon Dr.Arif Mati, në studimin e gjuhëve europiane, e madje të ashtu- quajtura « indo-europiane »(të vjetra dhe të reja),vetëm gjuha shqipe arrin ta bëjë të kuptueshëm atë, nëpërmjet dialektit geg të Shqipërisë : Zan, Zani që do të thotë - zë, zëri. E kjo përputhet plotësisht me vetë kultin e Zeusit në tempullin e Dodonës (orakullit të përmëndur në të gjithë Lashtësinë parahelene dhe arkaike).Të kujtojmë, se Pitagora rridhte nga një familje me origjinë tirrenase (Tirrenët ishin etni të afërta me Pellazgët) dhe ka gjasa, që ai ta mbante akoma mend gjuhën prindërore. (5)
- b- Satya **Loka** (*Sans.*) – shpjegohet :Vëndi i pastërtisë dhe mënçurisë së pafund. Në gjuhën sanskrite fjala « lok » nuk tregon «vënd », ndërsa në dialektin geg të shqiptarëve edhe sot kjo fjalë përdoret për vendin.
- c- Trilokhana (*Sans.*)- Emri i perëndisë më të rëndësishme në Indi-Shivës. Këtu kemi tre fjalë të pastra shqipe : tre (dial çam- tri)+lok/vënd+Hana = vëndi i Zotit/Hënë, e cila në besim simbolizohet me numrin 3. (6)



Sipas mitit, syri i tretë i Shivës ndodhet në ball dhe shpreh vendin e « energjisë krijuese » të Zotit- Hëna (dial.geg Hana), të cilën e mban mbi kokë.

Të tre rastet e marra nga shkrimet e sanskritishtes dhe greqishtes, që mbahen sot si gjuhët më të lashta, dëshmojnë se vetëm gjuha shqipe arrin t'iu jap kuptimin e saktë gjuhësor. Duke marrë në shqyrtim fjalë jo rastësore, por të përsëritura të sanskritishtes, pohon Petro Zheji : « Arrijmë në përfundimin se gjuha shqipe është më e lashtë se sanskritishtja », (7) rrjedhimisht, **Atlantido-Pellazgët ishin fiset me gjuhën më të lashtë në historinë e Euro- Azisë**. Vincenzo Gioberti (1801-1852), një prej figurave kryesore të Rilindjes italiane, pohon se gjuha shqipe përmban gjurmë të gjuhëve që qarkullonin në Greqi, para pushtimeve deukalioniane, dmth para formimit të popullsisë që emërtohet « hellene ». (*Primato*, Bruselles 1844T.II, p.133) (8)

E trajtuar gabim, nuk është vetëm teza « indoeuropiane » e shk.19, por edhe përcaktimi i drejtimit të emigrimeve parahistorike. « Është e qartë se nuk mjafton të nxjerrësh përfundime vetëm nga gjuha ! - pohon Lidio Cipriani (*Creta e l'origine mediterranea della civiltà*), i cili grumbulloi fakte mbi popullsinë e tre kontinenteve që rrethojnë Mesdheun - Në këndvështrimin e antropologjisë, edhe sot Kreta dhe jo Greqia, dikton nevojën e një përmbysje të plotë të tezës së drejtimit të valëve emigrimese zanafillore të qytetimit të sotëm europian: Jo nga Azia drejt Mesdheut, por prej tij në Azi; jo nga Veriu në Europën Jugore (teza « kurgan » e Maria Gimbutës-shën im), por nga Mesdheu drejt Europës Veriore ». (9) Ishin pellazgo-ilirët, vëren Xh.Katapano, që duke kaluar nëpër Kaukaz, i janë ngjitur vargmalit të Himalajave që në epokën e Gurit. (10) Nga këto marshime drejt Lindjes, grykat shkëmbore të maleve të Kaukazit, në lashtësi emërtoheshin « Portat e Albanit ». (11)

Fiset Pellazge dhe Dardano-Iperiotë, siç dëshmojnë në një material të më përshëm (F.Demi *Nga Dodona në Tibet*) patën një ndikim të fuqishëm mbi popujt aziatik. Mjafton të kujtojmë se « syri i tretë » i Shivës, emërtohet me foljen e gjuhës shqipe « bindu » dhe në ritet e tij përdoren simboli i shqiponjës dhe i dhisë. (F.Demi , *Bindu –emri që i dhanë Arbërit Perëndisë*) Këtë ndikim të fiseve shqip-folësve e ka ndjerë edhe Egjipti, fakt i përmëndur nga Platoni (12) dhe trajtuar për herë të parë shkencërisht prej eruditit arbëresh Xhuzeppe Katapano (*Thoti fliste shqip*).

Ngjashmeritë gjuhësore (jo gjithëmonë të trajtuara shkencërisht) të popujve europian, me gjuhën priftërore sanskrite, burojnë nga *PUSHTIMET* e fiseve pellazge, ndërsa me popujt e tjerë, sidomos të hapësirës Kaukaziane dhe Azisë së Afërme, nga *NGULIMET* e fiseve të tyre gjatë lashtësisë (fakt që nuk merret parasysh kur flitet për huazimet gjuhësore).

Për rrjedhojë: **Kanë qenë fjalët e gjuhës pellazgo-shqipe apo rrënjët e huazuara prej saj, shkaku i ngjashmërive midis gjuhëve të Lashtësisë Euro-Aziate.**

U zgjatëm jo pa qëllim mbi këtë tezë, sepse në shk.18-19 u ndërtua origjina më antishkencore e popujve dhe gjuhëve europiane, veçanrisht kur flitet për « fiset idoeuropiane greke » apo « protogreke », për të cilat nuk dihet gjuha që kanë folur, besimi, ritet, mitet apo traditat e vëndit (të panjohur) të origjinës, të sjella me vete në « atdheun e ri ».



(13)

Kjo duket qartë edhe në pasqyrën e hartës, e bazuar tek gjeografët e lashtë, përveç rasteve kur emërvëndi Megalë Hellàs (Hellas i Madh) për Siçilinë dhe kolonitë e Gadishullit italik, të shkruesve latinë të shekullit të 3-të, nga autorët moderne u zëvendësua me « Magna Graecia » (Greqia e Madhe).

Bizancio thotë se popujt e Greqisë (e jugut të Gadishullit Pellazgjik dhe Anatisë -shën im) kanë qenë : jonët ,aveadi, beotët, eololët, kaonët, lakonët dhe kolonitë e tyre si pontiçi, bithini, trojanët, arjanët, kariat, lyçi, panfili, çirenei etj. Homeri në Iliadë i quan athinasit Jonë, së bashku me kolonitë e tyre, ndërsa maqedonët dhe epirotët si fise Akeje. (14)

Historia e fiseve që e emërtuan veten - Shqipetar


Në tryezat akademike, sot vijnë të trajtohen dy teza për origjinën e këtij emri : Disa e nxjerin nga folja « ai që flet shqip » (që kuptohet qartë), ndërsa shumica e studiuesve, si Maksimilian Lambert, Rilindasit, Egerem Çabej, etj. nga emri i shqiponjës. Por , të gjithë bashkohen në përfundimin se, ka filluar të përdoret në periudhën e mesjetës, në shekullin e 15-të gjatë luftës së Skënderbeut kundër turqve. Trajtimi i origjinës së emrit « shqipetar » ka nxjerrë në pah, mungesën e njohurive të gjuhëtarëve të shk.19 dhe studiuesve të sotëm, për rolin e botkuptimit besimtar të fiseve zanafillore, në formimin e fjalëve dhe të emrave.

Në fillim qe **FJALA**, pohon Petro Zheji, e cila, si një relike e gjallë bart në vetvete urtësinë njerëzore ndër shekuj , në lindjen dhe zhvillimin e saj historik dhe prehistorik, një relike e gjallë që është e aftë të shpjegojë vetveten , mbasi ajo përfaqëson njeriun , është vetë njeriu me forcën

e pamposhtur – mendimin. (15) Në gjuhën e njeriut të Lashtësisë, këto cilësi i mbartin *EMRAT* dhe veçanërisht emri i shqiponjës në gjuhën arbërore-shqipe.

Mitet dhe arkeologjia dëshmojnë se shqiponja ka shërbyer si simbol i Krijuesit, siç e pohonte edhe Sami Frashëri (*Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*): « Kombi i tërë ka marrë emrin Shqipëtar dhe vendi ynë emrin Shqipëri, fjalë të bëra prej shqipes, Zogut të bekuar të Hyjit, që i faleshin prindërit e vjetër tanë dhe që e kemi në flamur. » (16) Historiani i Aleksandrisë, Filone (30 p. e.r.-45 pas e.r.) në (*Quaestiones et Solutiones in Genesis*) pohonte se, në besimin e lashtë, Shqiponja përfaqësonte : Zotin e dytë dhe Mënçurinë e tij. (17) Emrin e saj vijon ta mbaj popullsia Shqipëtare e shk.21, një dëshmi e pakundërshtueshme e lidhjes etnike me banorët e parë europian : Atlantido-Pellazgët.

Simbolet e shqiponjës dhe të « bijve të saj » - shqipëtarëve të lashtësisë - ndodhen në muzeumet më të famshme të Botës, njëri prej të cilëve ka qenë edhe Ramsesi II.



(18) Në fig.1 të Ramsesi II-të, shprehet simbolikisht Hëna e plotë (Zoti/femër pellazg) mbi gjoksin e shqiponjës (përfaqësuesja e saj në tokë), e cila qëndron mbas frontit të tij duke treguar natyrën hyjnore të faraonit. Gishti i drejtuar nga goja, shpreh me gjest, se fjala e tij është « ligj » hyjnor. Në fig.2 shikojmë kokën e mumjes së Ramsesit II, ku dallohet forma rrumbullake e kafkës dhe hunda - krrabë (me kurriz), tipare tipike të shqipëtarëve si e Gjergj Kastriot Skënderbeut në fig.3.

Emri **Faraon** [fara+(e) +(j)on → nga raca e jonë] e tregon etnin e tij në gjuhën e sotme shqipe, e përdorur edhe nga Aleksandri i Madh « Unë Aleksandri, bir i Filipit, mbretit të maqedonasve, (...) pinjoll i **Farës** së shquar të popujve Ilirikë të Dalmacisë dhe Liburnisë dhe të popujve të tjerë të së njejtës gjuhë që popullojnë Danubin dhe zonën qendrore të Thrakës...». (19) Edhe sot shqipëarët thonë « jemi **farefis** » për një familje të zgjeruar.

Fabre d'Olivet : *Histoire Philosophique du Genre Humain* , vell.I, f. 306, shkruan: « Nga fragmenti i Manetonit, dimë se i famshmi Seti (dinastia XIX) nuk ishte aspak me origjinë egjiptiane, pasi ai si mbret nuk mbante titullin Faraon, por atë Larthe , pra titullin që mbanin mbretërit etruskë. Dimë se Setit i zuri vëndin i biri Ramseti (ose Ramsesi) II, ndoshta më i madhi i monarkëve që sunduan Egjiptin ». Sipas Zef Katapanos « Prej Hermit, dimë se Etruskët janë

Trojanë dhe Trojanët janë Hititë dhe se këta janë Ilirë Shqipëtarë, si rrjedhojë: Ramsesi dhe Mojsiu janë shqipëtarë ». (20)

Emri « shqipëtar » nuk figuron në dokumentet e lashtësisë, por gjuhëtarët mund ta vërtetojnë lehtësisht duke zbuluar rrenjën e tij në dialektin e Çamërisë – Ipe (shqiponjë), e cila ka formuar emrin e lashtë - **Iperi** (Shqipëri), i përmendur edhe në hartën e mësipërme. Emri Epir apo Pieri (tek N.Ketta në shk.19 dhe Adamit Frasstari/Frashëri në shk.20) është i shkruesve , ndërsa në folklorin popullor të Çamërisë njihet me emrin Iperi.

Si përfundim, emri «shqipëtar », në ndërtimin e tij gjuhësor dhe historik, mbart mitin e lashtë besimtar, të krijimit të *NJERIUT* nga *ZOTI*. Me qënëse kjo tezë është trajtuar në botimin « *Sellenizmi, besimi që sundon Botën* » (f.102-104), nuk po zgjatem më tej.

Le të vijojmë gjurmimin e së Vërtetës (trashëgimia historike gojore apo librat historik), i pari për nga tematika në historinë e debatit shkencor...

Origjina mitike e fiseve « greke »

Burimi i vetëm i Historisë së Lashtësisë dhe i origjinave të popujve europianë ishin Mitet, ku kryesonin veprat e Homerit dhe të ndjekësve të tij të mëvonshëm. Të bazuarit vetëm tek mitet nga ana e studiuesve ka rreziqet e veta, vëren mitologu Aristidh Kola : « Dhe nënvizoj përsëri se me përparimin e qytetimit grek dhe me ardhjen e filozofëve e të profetëve profesionist , të ashtuquajturit - himne homerike (shumica, të paktën, janë krijime të kohës Helenistike), urtësia e miteve të vjetra harrohet e nuk kuptohet. Mitet klasike ose pas-klasike kanë një dozë të madhe budallallëku, e as që mund të krahasohen me mitet e vjetra » . (21)

Kjo vlen sidomos për tezën tonë . Megjith faktin se për emrin « grek » nuk njihet ndonjë mit, dokument besimtar parahistorik apo i lashtësisë dhe nuk është zbuluar ndonjë simbol arkeologjik në Euro-Azi që ta përfaqsojë atë, ai nënkuptohet nëpërmjet tre modeleve që afron Historia moderne e shk.19 -21:

1. Nëpërmjet mitit të Hellenit.
2. Emigracionit të fiseve Dore apo Akeje.
3. Qytetimit mikënan.

Le t'i marrim me rradhë.

[1] Në një bllok mermeri i njohur si « [Parian Chronicle](#) » i shekullit të 3 p.e.r. i zbuluar në ishullin Paros, sipas studiuesve, shkruhet se **Pthia ishte vëndorigjina e Hellenëve, emër me të cilin quheshin më parë Grekët.** (22) Sipas Ecateo dhe Ellanico nga Mitilena (shk.5 p.e.r.) për Hellenin mitik janë thurur shumë origjina, por historianët preferojnë mitin e Deukalionit sepse lidhet me Epirin, dhe nga ana gjuhësore e afronte me emrin e Sellenës dhe priftërinjve të Dodonës « sellë ». Në mitologjinë «greke » (pellazge), Helleni njihet si udhëheqës i tribuve Hellene në Pthia dhe djalinë e Deukalionit dhe Pirrës. (23)

Emrat e marra nga ky mit, mbi origjinën e emrit « grek » dhe të vëndndodhjes - Pthia, duke gjurmuar faktet shkencore historike, do të kemi pasqyrën e mëposhtme :

Hellen - në zanafill (Sellen), emër i një mbreti të Lashtësisë i cili kryente edhe detyrën e kryepriftit të perëndeshës Sellena në tempullin e Dodonës, emrin e së cilës mbante, krahas priftërinjtve « sellë », të përmëndur nga Homeri. Emri i njeriut –Hellen, shpreh emrin e besimit të pellazgëve - hellenizmin, (si emri i simbolit Kryq , [dial.çam-kriq] emërtoi besimin e kristianizmit dhe të Krishtit). Këtë e dëshmojnë edhe predikimet e Shen Palit (*Atti degli Apostoli*) ku «hellenë » përdoret si emër i besimit të kundërt me atë të hebregjeve (24)

Aristoteli e vendos vëndin e besimtarëve të Sellenës-hellenëve, Hellasin e lashtë në Epir, midis Dodonës dhe brigjeve të Achelous-it, vend i Sellëve (Aristotle, *Meteorologica*, [1.14](#)). Në kujtimet e tij, [François Pouqueville](#), konsull i Napoleon Bonapartit në Janinë shkruan (*Voyage de Grece* VI,35) se « **me emrin Epirot , historianët emërtojnë shqipetarët** ». (25).

Dhimitër Kamarda (1821-1882) pohon se, gjuha epirote (shqipe-shën im) në fondin e saj themelor, i afrohet më bindshëm me dialektet e shumta të fiseve më të lashta, të cilat në kohët historike formuan popullin hellenik. Në Epir, sikurse edhe në pjesën tjetër të Greqisë , Shqipetarët dhe Ellenët nuk kanë asnjë dallim , përveç faktit që të parët ishin më energjik. (26)

Shkruesit e lashtësisë, sikurse ndodh edhe sot, si pasojë e përdorimit të dialekteve apo gjuhëve të ndryshme, jo rrallëherë i kanë deformuar emrat. Kështu, tek Iliada , në pjesën kur Akili i drejtohet Zeusit pellazgjik të Dodonës (Hom.II, 16,233) përmendet emri i priftërinjve të Zeusit - **Selloi**, tek Scholiet përdoret **Elloi** , ndërsa Pindari do të shkruaj « rreth teje banojnë **Helloi** ». (27) Ky ndryshim i emrit me origjinë nga Sellena e Dodonës, nuk do të ndikonte në studimet mbi Lashtësinë, por duke patur parasysh se, në shk.19 nuk njihej besimi hënor i Atlantido-Pellazgëve, sikurse edhe sot, pati pasoja katastrofike : E gjithë mitologjia e Titano- Pellazgëve ju fal « grekëve të vërtetë ». Sipas Enciklopedise Britannika, lexojmë, Helleni mbret i Pthias, djalë i Deukalionit , djalit të parë të titanit Promethe, ju dha emrin të gjithë **Grekëve të vërtetë**, që për nder të tij u emërtuan **Hellenë**.(28) Për këta « grekë të vërtetë », deri më sot, nuk kemi asnjë fakt apo studim shkencor.

Deukalion - Emri i tij kuptohet me besimin pellazg dhe gjuhën shqipe : (Deu/Zoti+kali/rrënja « ka »→ energjia krijuese (Zoti) +on/jonë = Krijuesi ynë). Nikoll Ketta (Nicolò Chetta, *Tesoro di Notizie su de Machedoni*) shkruan se : Prometeo (pro/i pari+the/foli = i pari u tregoi zjarrin/dijen) i quajtur edhe Epimetho (epi/ipe/shqiponjë + më + the/flet = orakulli/prift që flet në emër të shqiponjës), të cilin Deodori e quan një nga emathiotet (fis pellazg), ishte i jati i Deukalionit, që e zgjeroi mbretërinë e tij nga Maqedonia deri në Kretë. Deucalioni ishte mbret në Thesali (Virg.G1,62, Ovid. M.1,318 ; 7,356), ku banonin fiset iperiotet/epiriotet (shqipetare). (29)

Pthia (it.Ftia) - në mitologjinë « greke » (pellazge) ishte qytet i Thesalisë, fiset e së cilës kishin emigruar nga krahina e Thesprotisë së Iperisë (Epirit) , pra ishin fise Iperiotet (shqipetare).

Epir – emër i deformuar në shkrimin greqisht, i krahinës së lashtë të Iperisë (Ipe, në dial.çam-shqiponjë), e përmendur nga Homeri në Iliadë si atdheu i Mirmidonëve, i themeluar nga Aiaksi (Aeacus-Eacus), bir i Zeusit. Ajaksi ishte gjysh i Akilit (Hakilit/që merr hak) i cili kishte baba Peleun (pelë-kali femër), nënë Thetin (Deti, perëndesh e detit) dhe nip Pirron (shqiponjë/shqipetarin). Pelopsi (i jati i Akilit) ishte i pari nga heronjtë pellazgë, sikurse Zeusi ishte i pari i zotave pellazg. (30)

Pirra- emër që, krahas atij të Pirro Burrit (shqiponjë +burr = shqipetar trim dhe luftëtar «burrë») dhe i vëndit Iperi (Epir), e kanë origjinën nga emri i shqiponjës në dialektin çam.

Dodona- Tempulli i lashtë i Pellazgëve ku shërbenin priftërinj Sellë, sipas emrit të Sellenës. Straboni (*Geography*,p.285,bookVII,chapter7) shkruan: Ky orakull, sipas Eforit (historian 405-330 p.e.r), u themelua nga Pellazgët që pranoheshin si populli më i hershëm i Gadishullit. Poeti shprehet : « O Lord Zeus, **Dodonas , Pellazgjik** »⁴⁵⁷. (...) Në kohët e lashta, Dodona ishte nën zotërimin e Thesprotëve; sikurse edhe mali Tomarus⁴⁶⁴ apo Tmarus, në këmbët e të cilit ishte ndërtuar tempulli. Të dy poetët tragjik së bashku me Pindarin, e quanin « **Dodona Thesprote** ». (31)

Përsa më sipër, **emri HELLENË është i miteve të etnive pellazgo-shqipetare**, që ndiheshin **BESIMTARË** të Zotit- Hënë të Dodonës dhe pranoheshin si « sellenë / hellenë ».

Këtë fakt e kanë ditur të gjithë shkruerit e lashtësisë, shqipetarët dhe priftërinjtë ortodoks të shekullit të 19-të, por edhe filozofët ortodoks të ditëve të sotme. Sipas Diodorit të Sicilisë, Leka (Aleksandri) i Madh, si aiakas i devotshëm ndaj Dodonës, para se të vdiste, kishte caktuar një sasi të madhe ari (1500 telente, afro 4 kuintalë) për ndërtimin e një faltoreje tjetër të Zojzit (Zeusit) pellazg në Dodonë. (32) Në qelshen e tij ai mbante simbolin e besimit “sellenik” Hena/Ylli si e mbretërisë së Arbërve të mesjetës.

[2] Akej – Dorët dhe fiset e tjera

Për origjinën pellazge të familjes së Akilit , emrin e të cilit e morrën fiset e mbretërisë së tij, « aleanca ushtarake » kundër Trojës dhe krahina (Akaia), na e sqaron Herodoti dhe Pausanja (Hdt.7. 94 ; Paus.7.1) : Banorët autokton të Akaisë thuhet se ishin Pellazgë dhe thirreshin Aegialeis (*Αἰγιαλαῖς*), emër i lashtë i vendit. (33) « **Nuk ekzistonte asnjë dallim etnik, fetar apo kulturor midis akejeve dhe trojanëve** », dëshmon Dr. Arif Mati. (34) Ky fakt shprehet në mitin e perëndisë së Detit. Ishte Posejdoni , që së bashku me Apollonin i ndërtuan muret e Trojës mbretit Laomedon (35), ndërsa Homeri përshkruan zëmërimin e Posejdonit, babait të Akilit, i cili mbështet trojanët kundër ushtrisë akeje.(36)

Homeri ishte i pari që përmëndi (një herë) emrin « panhellenë » për fiset e aleancës Akeje në Luftën më të famshme të lashtësisë, për Hellenën e bukur , pasurinë e Trojës dhe pushtimin e udhëkryqit më të rëndësishëm Lindje-Perëndim. Studiuesit modern janë të bindur se ky emërtim është përdorur prej tij si sinonim, për të nënvizuar etninë e përbashkët « greke » të tyre, sipas formulës : Panhellen = të gjithë Hellenët = të gjithë Grekët.(37)

E vërteta është se, emri Hellen është historik dhe në lashtësi emri **shprehte edhe rolin (funksionin) e qënjes së cilës i ngjitej** : Selleni (Helleni) ishte mbreti / kryepriфт që mbante emrin

e perëndeshës Sellena. Homeri , nuk i dha shumë rëndësi emërtimit « panhellenë ». Ai e përdori thjesht për të dalluar ushtrinë akejase e cila vinte nga hapësira ku ndododhej tempulli i Dodonës, prej fiseve që mbështetën mbretin Priam në Azinë e Afërt, pra për një dallim gjeografik, jo etnik.

Që emri « panhellenë» lidhet me besimin e përbashkët, e përshkruan Tuqiditi (*"Histories", I, 132*) : Për të përjetësuar fitoren e shkëlqyer mbi Persianët dhe meritën e Pausanias, Kryekomandantit të Hellenëve, në tempullin e Delfit ju skalit një përkushtim. Ndergjegjësimi i një bashkësie «panhellenike » u mbështet prej festave fetare, veçanërisht të Mistereve eleusine.(38)

Emri Hellen, i cili në mite lidhet me paraardhësin e fiseve Akeje, Dore dhe fiseve të tjera, gjëndet edhe në kampin e trojanëve. Helleni, djali i Priamit të fiseve Dardane, i cili sikurse motra e tij binjake Kasandra, kishte dhuntinë të zbulonte profecitë. Ai u tregoi sekretin e orakujve palës kundërshtare se, Troja mund të pushtohej nese djali i Akilit, Neoptolemeu do bashkohej me ta. Helleni ndërtoi Butrintin - Trojën e re - në Iperi (Epir), ku sipas Virgjilit (Eneide, III), e gjeti Enea. (39) Duke e ditur rëndësinë e madhe që kishte emri në lashtësi, si mundet një pinjoll i familjes mbretërore dardane të huazonte emrin e tij nga fiset etnikisht të huaja , sipas historianëve modern, atyre « greke »? Fakti që mbreti/kryeprift i akenjve dhe ay i trojanëve kishin emrin me origjinë nga Sellena e Dodonës (pra të besimit hënor), verteton edhe një herë, se fiset «akeje », « dore » apo ato «panhellene », së bashku me fiset trojane i përkisnin etnisë pellazgo-arbërore.

Flitet shumë për fiset Dore si “greke”, ndërkohë që shkruesit e lashtë pohojnë të kundërtën: Sipas Herodotit nga Halikarnasi dhe Strabonit, eolët dhe akejtë ishin pellazge. Studiuesi gjerman Dorfmüller vëren se edhe dorët ishin pellazgë dhe me emrin ”dore” për herë të parë u quajtën në Peloponez, ndërsa në Pind ata quheshin Maketë (Maketai). Nga emri i ilirit nga Pindi - Maketa dhe Maketai u formua emërtimi për popullin pellazgo (thrako)-ilir Makedonia. (40) Ndërsa tek Dh.Kamarda lexojmë se studiuesi Ferrari (Costumi d'Europa) ka treguar se zakonet e popullsisë shqipetare (albanesi) të rikujtojnë qartësisht Maqedoninë dhe Dorët e lashtë. (41)

Nuk mund ta quajmë një lajthitje rastësore të Historisë botërore, e cila vijon të mbështetet tek formula pa asnjë fakt: Hellen = Grek, kur shkruesit e lashtë dhe modern, sidomos eruditët arbëresh (shk.18-19) të Italisë, theksonin se “Është e qartë që Historia, jo më pak se Gjuhësia, dëshmojnë në çdo periudhë, lidhjet e ngushta të tribuve iliro-maqedono-epirioete me ato ellene, që janë eolo, dorë, jonike. (...) Një shumicë fjalësh të dialektit dorik, nuk mund të kuptohen mire me ane të greqishtes, ndërsa mund të kuptohen fare mire me anen e rregullave të gjuhës ilire” . Studiuesi gjerman Hans Krabe (42).

[3] Qytetrimt mikenian

Sipas Fjalorit historik të Enciklopedisë Treccani (2010), ky emërtim i është vënë nga emri i qytetit të lashtë «grek » në Argolide ,Peloponez, i cili pati, gjatë shk.15 -12 p.e.r., shkëlqimin më të madh të «qytetrimt mikenian ». (43) Ky qytetrim u lidh me zbulimet e pallateve madhështore në ishullin e Kretës dhe u njoh si qytetrimi më famshëm i Lashtësisë. Sipas studiuesit të gjuhës «indoeuropiane », Francisco Villar « Ishte ardhja e Grekëve-Indoeuropianë që zhvilluan në Greqi atë që ne e përcaktojmë si Qytetrim mikenian ». (44)

Por studiuesi i mitologjisë së lashtë, Francis Vian, vëren se : Do të ishte më e drejtë të flitej për qytetrim «akejas » që të zëvendësonte mbiemrin «mikenas » i cili ka vlerë gjeografike.(45) Ky emër dhe ky qytetrim janë fabrikuar fund e krye nga arkeologët modern, veçanrisht nga Heinrich Schliemann , vëren Dr.Arif Mati (*Mikenët=Pellazg*), pra është krejtësisht i parregullt. (...) Nga zbulimi i tabelave prej argjili në Pilos (v.1250 p.e.r.) me një shkrim të mbiquajtur Linear B , që u dëshifrua nga Michael Ventris dhe më vonë John Chadwick, u nxorr hipoteza se ishte një formë e « greqishtes arkaike » që përdorte gërmat e alfabetit kretas (Linearin A), duke shpallur se bëhej fjalë për gjuhën e Mikenëve, ndërkohë që Pellazgët ishin zotër të vëndit. (...) Pra si mund të trajtohet një gjuhë paragreke se është gjuhë greke, ndërkohë që grekët nuk ekzistojnë ? (46)

Që qytetrimi « minoik » dhe « mikenian » ka qenë i fiseve shqip-folëse e dëshmojnë edhe emërvendet. Në Kretë ndodhet një ultësirë e rrethuar prej masive malore Ida, Asteroussia dhe Dikte, e quajtur shqip Messara (mes + ara = ara/toka që ndodhej në mes [të maleve]) ku ndodhej qyteti Phaistos, banorët e të cilit morrën pjesë në Luftën e Trojës.(47)

Kretasit messapë, sipas Tuqididit , në vitin 413 p.e.r. mbështetën qytetin e Athinës në luftën e Peloponezit në emër të traktateve të lashta të miqësisë të quajtura “ **palaiia philia**”, shqip : pal /bëhen palë/ bashkohen +(ph/f)fill = palët që lidhen me marrëveshje.(48)

Gjuhëtari dhe mitologu Niko Stillo (*Etruskishte-Toskërishte*) pohon se: Mikenet, apo më saktë Eneskët mikenej, flisnin gjuhën jonike dhe konkretisht dialektin çam, të shqipetarëve të Iperisë (Epirit) (49)



Froni i Mbretit të Mikenës në qytetin Minosse,

Cnosso. (1550-1525 p.K)

Në mitet më të njohura të lashtësisë ai njihet me emrin e Minotaurit, i cili përbëhet prej : Mino+taur dmth Mino/ kau dhe sipas N.Stillos bëhet fjalë për mbretin e Mikenës - Mino, i njohur edhe me shumë emra të tjerë. (50) Për rrjedhojë, Qytetrimi të cilin historia botërore e njih si e « grekëve të lashtë », ka lulëzuar në mjedisin e fiseve më të famshme pellazge, ato Iperiotë, fakt i fshirë tinëzisht nga Historia botërore.

Pra qytetrimi « minoik » dhe « mikenian » ka qenë në fakt qytetrim i fiseve që flisnin gjuhën e Shqipetarë-Arbërve të sotëm.

Adamit Frasstari (*Les Pelasges et leur descendants les Albanais*,1902) vëren se, në kohën e qytetimit « minoik » e « mikenian » dhe të miteve olimpikë të Homerit, **VËND KRYESUES** dhe

të dokumentuar nga autorët e lashtësisë, e zinin fiset e Epirit. Epiri, në Albaninë e jugut (Shqipërinë e lashtësisë-shën im), ishte qendra e racës më të mirë të Pellazgëve hyjnorë të Homerit. Mollosët, Myrmidonët, Sellët apo Hellët, apo Graeci (siç i quanin romakët fiset iperiotë -shën im), të mbledhur përreth oraklit të Dodonës pranë malit Tomor, janë përmendur prej autorëve të ndryshëm, sidomos tek Iliada **si ushtarë të Akilit** (...). Si rrjedhojë, ishte gjuha pellazge ajo, me të cilën këndoheshin odet e Olimp, të Orfeut, të Thamysëve (Çamëve-shën im) etj. gjatë festimeve të Muzave të Pierisë (Iperisë/Epirit), perëndive pagane dhe heroizmave të Herkulit. (51)

Një tjetër fakt i rëndësishëm historik, u paraqit para Akademisë Egjiptiane (1902) prej A.Frasstarit (Frashërit): « U desh të kalonin shumë shekuj lufrash dhe emigrimesh të ngadalta, që **KJO RACË EPIRIOTESH ARRITI TË ASIMILOJË** të gjithë popujt e tjerë **TË NJË GJAKU**, të Beotisë, Attikës, etj. Një orakull i ri i Dodonës u ngrit në Thesali sipas shëmbullit të atij në Epir. (...) në lartësinë e malit Orthys, Deukalioni themeloi një orakull tjetër të famshëm, tempullin e Delfit, i cili do ta zëvendësoj emrin Pellazg me atë Hellenë ». (52)

Siç u sqarua edhe më lart, emri Hellenë, shprehte besimin e fiseve autoktone, sikurse edhe ai Pellazg, prandaj nuk bëhet fjalë për « asimilim » etnik sepse të gjithë ishin « të një gjaku », por për pushtime të trevave të Europës mesdhetare dhe detyrimin e banorëve tu bindeshin ligjeve besimtare dhe civile të mbretërve Pellazgë, Iperiot apo Dardan, që sunduan në Iperi (Epir).

Që në historinë e lashtë të Iperisë ka patur edhe mbretër dardanë, e dëshmon edhe historia. Në tempullin e Delfit « hellenik » adhurohej Perëndia Apollon, i cili emërtohej « mbiverior » (prej veriu) jo vetëm nga Hesiodi, Pitagora, por edhe Olini, i përmendur nga shkruarit e vjetër si poet hymnesh për Apollonin. (53) Edhe në qytetin e famshëm të Athinës, vëren Aristidh Kola, pjesa më e madhe e fiseve, këmbëngulnin se e kishin prejardhjen nga lapët (labët), dhesprotët (çamët), molosët dhe dardanët, që njihen si fise pellazge. (54)

Në arenën historike të Gadishullit Pellazgjik, megjithë « suksesin » e botimeve mbi Lashtësinë për t'ï fshirë bashkësitë e mëdha fisnore Atlantido-Pellazge, **faktet dëshmojnë se ishin IPERIOTËT dhe DARDANËT, faktorët kryesorë qytetruar të Euro-Afro-Azisë.** « Nga të gjitha fiset që shtriheshin në lashtësi, nga Danubi deri në Azinë e Vogël (pohon studiuesja e shkrimeve pellazge-Nermin Vlora Falaski) më të zhvilluarit ishin ato që perfshiheshin në trojet nga Kosova deri në Çamëri ». (55) Në kundërshtim të tezave akademike për parahistorinë, nuk ka patur asnjë kolinizim apo asimilim, etnik, gjuhësor apo qytetërues « mikënie » prej fiseve me një emërtim, larg të qenit historik, « helleno-greke » apo qytete « koloni greke ».

Emri besimtar Pellazg shpreh periudhën e matriarkatit, kur u hyjnizua Dheu, kur Atlantido-pellazget e shpallën veten « bij të Tokës ». Emri besimtar Hellen, shpreh periudhën e mëvonshme të olimpikëve me mbret Deukalionin, kur u hyjnizua njeriu tokësor - Sellena, e njohur si Diona apo Menes dhe emra të tjerë. Të njëjtin fakt e përmend edhe Thuqididi se, « Para Helenit Deukalion ky emër (Hellas) aspak nuk ekzistonte, popujt të tjerë veç e veç, dhe populli pellazgjik i dhanë vendit emrin e tyre në një gjerësi të madhe ». (Thuqididi, lib.I, KAP.3) (54)

Por fiset autoktone, duke qënë shumë fanatik ndaj trashëgimisë së të parëve, si emërtim etnik gjithëmonë kanë privilegjuar emrin e ndërmjetësit (orakullit) më të lashtë të besimit të tyre – atë

të Shqiponjës, *IPE* (shqipëtar), i cili i shoqëroi gjatë të gjithë historisë së tyre qindramijë-vjeçare deri në ditët e sotme.

Problemi i fundit që u ngrit në « kuvendin » e Maleve ishte ay i Metodës, në trajtimin e figurave historike: Ku qëndron e *VËRTETA* e origjinës së Aleksandrit të Madh, sipas trashëgimisë gojore apo botimeve botërore akademike ? Për të gjukuar për këto dy burime, duhet të sqarojmë fillimisht rëndësinë e tyre ...

Historiografia e lashtë – Historia e parë

Sipas Enciklopedisë Britannica, « Gjatë dhjetra-mijë vjetësh, njerëzit e kanë treguar të kaluarën pa shkrim. Historia gojore akoma është e rëndësishme në çdo kënd të Botës , e cila dëshmon se njerëzit, edhe në mungesë të të shkruarit mund ta kenë një ndjenjë të sofistikuar historike ». (55)

Në shkurt 1806 konsulli francez Pukëvili kalon nëpër Tepelenë. Plot 2004vjetësh, kujtesa e vëndasve mbante mend manovrën rrethuese të Tit Kuinkt Flaminit kundër Filipit V. Pukëvili dëgjoi aty stratagjemën e bariut, dërguar nga tradhtari epirot Haropi tek gjenerali romak, dhe e shënon atë dëshmi kujtese masive , vërtet mahnitëse në librin e vet (1821) (56)

Në kulturat e të gjithë popujve flitet për të kaluarën, mbi bëmat e të parëve, mbi perënditë, kafshët e shenjta dhe ngjarjet natyrore dhe njerëzore, të cilat kanë lënë gjurmë të thella në kujtesën e shumë brezave. Të gjitha këto mbresa janë përcjellë gojarisht në popull, siç e përmend udhëtarja amerikane Rose W. Lane për tregimin e malësorit analfabet : « këtë tregim e dëgjova në Thethin e Epërm në pranverën e vitit 1921» :

« Leka i Madh ka lindur në Emadhinë e Matit. Atë kohë ka pasur dy kryeqytete të mbretërisë së bashkuar, ka qenë Pela mes Selanikut dhe Manastirit dhe Emadhia, kryeqyteti i vjetër që shtrihej në luginën që tani quhet Mat. Në Pela dhe Emadhia, Filipi II-të kishte shtëpi të mëdha (...) Por e vërteta është se, para se të lindte Leka i Madh , e ëma iku nga Pela dhe u kthye në qytetin e Emadhisë dhe Leka i Madh u lind aty (...) Ai i hipi kalit për herë të parë kur vajti në Pela (...) nga kali, Leka i Madh e pa për herë të parë të atin ».(57)

Vërtetësia e tregimit të malësorit dhe në përgjithësi, tregimi popullor, bazohet tek fakti, siç e sqaron Enciklopedia Britannica se, « të gjithë personat për të cilët flasim, kanë jetuar dhe ngjarjet e përshkruara kanë ndodhur në të kaluarën. Historianët nuk mund të thonë asgjë mbi njerëzit dhe ngjarjet, po të mos mbështeten nga të dhënat e dokumentave ». (58) Por, në asnjë dokument nuk janë paraqitur faktet mbi jetën e Aleksandrit, të mbledhura nga mbresat që ka lënë tek njerëzit ku u lind, u rit e që e ndoqën deri në Indi. Ai u përshkrua në « historinë » e tyre ashtu siç ishte në jetë, pa paragjykim, shtrëmbërim apo hyjnizim, thjesht i parë nga syri njerëzor.

Se sa e vërtetë është kujtesa gojore e Kombit shqipëtar e dëshmojnë gjurmët arkeologjike dhe emërvendet në trevat e tyre. « Në verën e v.1922 ,vizitova Matin , e shoqëruar nga Annette Marquis dhe Rrok Perolli (...) , pohon R.Lane. Në vëndin e qytetit Emadhia (pranë Bulqizës së sotme-shën im) hasëm në gjurmë që na u dukën me siguri të mbetura nga puna e dorës së njeriut. (...) Fshati i sotëm gjëndet në shpatin e malit ku ka qenë qyteti. Fshatarët thonë se kanali është ndërtuar nga Filipi II-të (...) fshatarët e anës së Matit shpreheshin lirshëm për « qytetin e moçem të Emadhisë » dhe « vëndlindjen e Lekës së Madh ».(59)

Për të *VËRTETËN* në kuvëndin e malësisë së Thethit, na ndihmon edhe Heroi i Kombit tonë - Gjergj Kastriot Skënderbeu në letrën drejtuar Princit të Tarantos, ku me një gjuhë krenarie pohon : « Fiset tona madhështore ishin Epirotët prej të cilëve e ka origjinën Pirro (...) në se do thuash që Albania (Shqipëria) është pjesë e Maqedonisë , del se paraardhësit e tyre ishin akoma më fisnikë, të cilët nën udhëheqjen e Aleksandrit të Madh arritën deri në Indi, duke nënshtruar të gjithë ata që me vështirësi ju kundërvunë ». (Cf.Pompilio Rodotà *Storia del rito greco in Italia*, I,III,2) (60)

Lidhur me problemet aq të rëndësishme të qytetimit evropian, në shkrim u sollën shumë prova shkencore (të trajtuara edhe nga studiues të tjerë, shqiptar dhe të huaj), të cilat dëshmuar se : Historia e Lashtë e Europës mesdhetare, në botimet akademike është keqtrajtuar dhe nuk pasqyron të *VËRTETËN*. Me këtë mendim pajtohet edhe malësori i moshuar i Kuvëndit të Thethit, kur dëgjoi miket e huaja të tregonin se çfarë shkruanin librat mbi Aleksandrin e Madh : « Nëse zonjat amerikane duan të dinë se ç’na kanë thënë të parët tanë, që e kanë mësuar nga etërit e tyre dhe ata nga gjyshërit, do t’iu tregoj. Të gjitha këto (histori) janë shumë të moçme dhe asnjë nuk shkruhet në libër, ndaj janë të vërteta ». (61)

I takon shkencës Albanologjike detyra, ta njohë « historinë gojore » të shqiptarëve dhe t’u ndriçojë me fakte shkencore, Institucioneve akademike botërore të *VËRTETËN*, se : Aleksandri i Madh nuk ishte « grek » e as « sllav » i Maqedonisë, por farë e trojeve Arbërore.

Fatbardha Demi (fatbardha_demi@yahoo.com)

10. 09.2020

.....

Fjalët kyç : Mungesa e fakteve për “fiset Indoeuropiane” dhe të “grekëve indoeuropian”. Metoda të gabuara në trajtimin e tezës “gjuhë indoeuropiane” dhe të emigrimit të fiseve në Parahistori. Gjuha shqipe më e lashtë se Sanskritishtja dhe arësyeja e ngjashmërive të gjuhëve evropiane me shkrimin sanskrit të Lashtësisë. Emri “grek” dhe emri “shqiptar” në dritën e gjuhësisë dhe mitologjisë. Kujtesa popullore – dëshmi historike në shkencën e Lashtësisë.

Përmbledhja:

Nga 14 teza të shtruar në shk. 19-të e deri në ditët e sotme dhe e para historikisht, origjina e fiseve Indoeuropiane shikohet në Indi, bazuar tek gjuha sanskrite e pranuar si më e lashta.

Kjo metode ka mangësi themelore si : 1. Janë krahasuar gjuhët e vjetra me të rejtat , si dhe dukuritë gramatikore, si mbaresat, parashtesat, nyjet, kohët e foljeve, etj. që janë dukuri të periudhave më të vona historike të gjuhëve në studim. 2.Nuk është marrë parasysh historia e popujve, mbi gjuhët e të cilëve behej studimi, levizjet dhe përzjerjet (sidomos me ato mongole) që kanë pësuar ndër shekuj apo çfaqja e vonshme si popull dhe gjuhë, siç janë fiset sllave të Gadishullit ballkanik.

Eshtë trajtuar gabim, jo vetëm teza « indoeuropiane » e shk.19, por edhe përcaktimi i drejtimit të emigrimeve parahistorike. Ishin pellazgo-ilirët, vëren Xh.Katapano, që duke kaluar nëpër Kaukaz, i janë ngjitur vargmalit të Himalajave që në epokën e Gurit. Fiset Pellazge dhe Dardano-Iperiotë, siç dëshmohet në një material të më përshëm (F.Demi *Nga Dodona në Tibet*) patën një ndikim të fuqishëm mbi popujt aziatik. Mjafton të kujtojmë se « syri i tretë » i Shivës, emërtohet me foljen e gjuhës shqipe « bindu » dhe në ritet e tij përdoren simboli i shqiponjës dhe i dhisë.

Ngjashmeritë gjuhësore (jo gjithëmonë të trajtuara shkencërisht) të popujve europian, me gjuhën priftërore sanskrite, burojnë nga *PUSHTIMET* e fiseve pellazge, ndërsa me popujt e tjerë, sidomos të hapësirës Kaukaziane dhe Azisë së Afërme, nga *NGULIMET* e fiseve të tyre gjatë lashtësisë (fakt që nuk merret parasysh kur flitet për huazimet gjuhësore).

Burimi i vetëm i Historisë së Lashtësisë dhe i origjinave të popujve europianë ishin Mitet, ku kryesonin veprat e Homerit dhe të ndjekësve të tij të mëvonshëm. Megjith faktin se për emrin « grek » nuk njihet ndonjë mit, dokument besimtar parahistorik apo i lashtësisë dhe nuk është zbuluar ndonjë simbol arkeologjik në Euro-Azi që ta përfaqsojë atë, ai nënkuptohet nëpërmjet tre modeleve që afron Historia moderne e shk.19 -21.

Mitet e autorëve të lashtë të ballafaquara me faktet shkencore historike dhe gjuhësore, dëshmojnë se **emri HELLENË është i miteve të etnive pellazgo-shqipetare**, që ndiheshin *BESIMTARË* të Zotit- Hënë të Dodonës dhe pranoheshin si « sellenë / hellenë ». Qytetrimi « minoik » dhe « mikenian » ka qenë i fiseve shqip-folëse të etnisë Pellazge sikurse edhe fiset Akeje , Dore dhe Dardano-Iperiotë.

Si përfundim : Tregimi popullor (legjendat, folklori etj.) bazohet tek fakti, siç e sqaron Enciklopedia Britannica se, “ të gjithë personat për të cilët flasim, kanë jetuar dhe ngjarjet e përshkruara kanë ndodhur në të kaluarën”. I takon shkencës Albanologjike detyra, ta njohë « historinë gojore » të shqipetarëve dhe t’u ndriçojë me fakte shkencore, Institucioneve akademike botërore të *VËRTETËN*, se : Aleksandri i Madh nuk ishte « grek » e as « sllav » i Maqedonisë, por farë e trojeve Arbërore.